



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**KUVENDI I KOMUNËS
KOMITETI PËR KOMUNITETE**

EKSTRAKT

nga procesverbal i mbajtur më 5 qershor 2017, në mbledhjen e XXXVI (tridhjetegjashtë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.05'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Shaban Osmani, Bahri Selimi, Radisav Perović, Sabri Hamiti, Valmire Lahu, Xhafer Ademi, Mefail Rama dhe Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Bashkim Bajrami, Policia Kufitare, Laia Pau Romani dhe Skender Shatri OSBE, si dhe Zoltan Poskas, KFOR- LMT.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27 prill 2017

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Ngritja e grupit punues për sensibilizimin e maturantëve të komuniteteve pakicë të cilët përfundojnë shkollimin e mesëm të lartë për regjistrim në studime – fakultete

z. Xhafer Ademi, theksoi, aktualisht maturant në shkolla të mesme të larta, nga komunitetet RAE, janë 8 persona dhe ne sigurish pas testit të maturës këta persona do t'i sensibilizojmë për regjistrim në studime, mirëpo prej përvoje them se është numër shumë i vogël i atyre të cilët regjistrohen në ndonjë fakultet. Për momentin nga radhët e komuniteteve RAE janë vetëm dy studentë të rregullt, edhe pse kanë qenë pesë.

Përveç vështirësive për regjistrim në ndonjë fakultet për pjesëtarët e këtyre komuniteteve vështirësi paraqet edhe gjendja e rëndë sociale.

Në fund dëshiroj të theksoj se për regjistrim në shkolla të mesme të larta nuk kemi probleme ngase raportet me Drejtorin e Arsimit dhe drejtorët e atyre shkollave janë në nivel dhe ne deri tash nuk kemi pasë vështirësi në këtë drejtim.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, lidhur me çështjen për të cilën jemi duke debatuar, kam biseduar me z. Agim Veliun, i cili më ka premtuar se në këtë drejtim do të ndihmojë në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të tij, mirëpo gjithsesi është i nevojshëm edhe angazhimi i jonë. Sa i përket regjistrimit në studime duhet të angazhohemi maksimalisht dhe nëse arrijnë një numër i maturantëve të regjistrohen në fakultete, sigurimi i bursës do të jetë problemi më i vogël.

z. Bahri Selimi, theksoi, sa i përket regjistrimit në fakultete duhet pasë parasysh se në disa fakultete kriteret janë më të lehta andaj duhet orientuar në këto të fundit siç është rasti u fakultetit teknik ku konkurenca është më e vogël.

z. Shaban Osmani, theksoi, saçi përket pjesëtarëve të komuniteteve RAE problem është vetëm regjistrimi në fakultet ngase bursën të gjithë ata që arrijnë të regjistrohen e kanë të garantuar, kur dihet se edhe nxënësit e shkollave të mesme të larta e kanë të siguruar bursën.

Bazuar në këtë ne na mbetet që sipas mundësive tona t'i sensibilizojmë dhe t'iu ofrojmë ndihmën e mundshme që numër sa më i madh i maturantëve të regjistrohen në fakultete.

Pas propozimeve dhe votimit u konstatua se grupi punues përkatës, u ngrit në këtë përbërje:

1. Shaban Ahmeti, kryesues .
2. Xhafer Ademi, anëtar, dhe
3. Mefail Rama, anëtar

- 4. Ngritura e grupit punues për pjesëmarrje në debate dëgjimore në procesin e hartimit të projektbuxhetit të Komunës për periudhën 2018. - 2020**

z. Xhafer Ademi, theksoi, çështja për të cilën jemi duke debatuar është me rëndësi të veçantë për Komunitetet RAE ngase e kemi donatorin i cili ka shprehur gatishmëri me financuar për meremetimin e shtëpive me kushte që Komuna të participojë në këtë projekt.

Në këtë vit kemi dështuar për meremetimin e 25 shtëpive ngase Komuna nuk ka pasë mjete të planikuara për participim.

Duke u bazuar në këtë është shumë e rëndësishme që në procesin e buxhetor për vitin 2018 të informohen strukturat relevante dhe të parashihen mjete të caktuara buxhetore për realizimin e projektit të cekur.

Donatori, me të cilin jam në vazhdimësi në kontakt më se një vit, e ka marr përsipër realizimin e këtij projekti nëse Komuna i siguron 30% të mjeteve për participim.

Në kuadër të këtij projekti do të përfshihet edhe ndonjë familje e komunitetit shqiptar.

Gjithashtu donatori nuk e ka të kufizuar numrin për meremetimin e shtëpive, por ky numër varet se sa participon Komuna.

Donatori përkatës këtë vit është duke realizuar projektin e cekur në Ferizaj, Lipjan dhe Fushë Kosovë.

Në vazhdim pas propozimeve dhe votimit u konstatua se grupei punues përkatës, njëzëri u ngrit në këtë përbërje:

1. Shaban Ahmeti, kryesues
2. Shaban Osmani, anëtar
3. Xhafer Ademi, anëtar
4. Sabri Hamiti, anëtar, dhe
5. Mefail Rama, anëtar

5. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11.20'.

Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi

Nr. 01-060/04-45842/17
Podujevë,
5 qershor 2017

Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti